



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2023:253722

Datë: 04.03.2024

Numri i dokumentit: 05405168

C.nr.4045/2023

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN-Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Uran Zogaj, në çështjen juridike kontestimore të paditëses H.B.J. nga Prizreni, të cilën me autorizim e përfaqëson av. A.H. nga Prizreni, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit-Drejtoria Komunale e Arsimit, Prizren, të cilën e përfaqëson V.I.Xh. nga Prizreni, me objekt të kontestit kompensimi i shujtave ditore dhe pagës jubilarë, vlera e kontestit 621.97 euro, jashtë shqyrtimit kryesor, më datë 04.03.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET pjesërisht e bazuar kërkesëpadia e paditëses H.B.J. nga Prizreni.

II. DETYROHET e paditura Komuna e Prizrenit, Drejtoria Komunale e Arsimit, Prizren, që paditëses H.B.J. në emër të shujtave ditore për 199 ditë pune për vitin 2022 (për periudhën kohore prej datës 01.01.2022 deri më datën 21.11.2022), t'i kompensoj shumën prej 398.00 euro dhe në emër të shpërblimit jubilar për 10 vite përvojë pune, t'ia kompensoj 50 % të pagës bazë (421.00 euro) në shumën prej 210.50 euro apo shumën e përgjithshme prej 608.50 euro, me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor, e cila fillon të rrjedhë nga data e paraqitjes së padisë më datë 21.11.2023 e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm.

III. DETYROHET e paditura, që paditëses, t'ia kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 124.00 euro, në afat prej 7 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm.

IV. REFUZOHET e pabazuar pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditëses, përtej shumës së gjykuar sikur në pikën II. të dispozitivit të aktgjykimit deri në shumën e kërkuar prej 621.97.00 euro, përkatësisht shuma prej 13.47 euro, në emër të shpërblimit jubilar për 10 vite përvojë pune.

A r s y e t i m

Paditësja H.B.J. nga Prizreni, përmes të autorizuarit të saj av. A.H. nga Prizreni, pranë kësaj gjykate ka parashtruar padi, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit-Drejtoria Komunale e Arsimit, Prizren, të cilën e përfaqëson V.I.Xh. nga Prizreni, me objekt të kontestit kompensimi i shujtave ditore dhe pagës jubilarë, vlera e kontestit 621.97 euro.

I autorizuari i paditëses në padi ka theksuar se paditësja është në marrëdhënie pune në ShFMU "Shtjefën Gjeçovi" në fshatin Zym, Komuna e Prizrenit. Ka shtuar se paditëses i takon kompensimi për shujtat ditore nga 2 euro për çdo ditë pune dhe shpërblimi jubilar për 12 vite përvojë pune në shumë prej 50% të pagës, sipas nenit 35 par. 7 dhe 8 të Kontratës Kolektive të

Arsimit në Kosovë dhe Ligjit të Punës, por që e paditura nuk e ka bërë kompensimin për ditët e pranisë në punë nga 2 euro, prej datës 01.01.2022 deri më 21.11.2022 dhe 50% të pagës jubilarë të paditëses. Pasi që e paditura nuk e ka përmbushur kërkesën e paditëses vullnetarisht, gjykatës i ka propozuar që të merr aktgjykim dhe ta aprovojë kërkesëpadinë në tërësi si të bazuar. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

E paditura, përmes përfaqësueses ligjore të saj, në përgjigjen në padi e ka kontestuar padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit, lidhur me kompensimin e shujtës ditore. Ka theksuar se bazuar në njoftimin e Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit me numër 01B/488, të datës 21.11.2022, për shkëputjen e Kontratës Kolektive të Arsimit të datës 22.01.2021, padia dhe kërkesëpadia e paditësit është e pabazuar. Po ashtu sipas të autorizuarës së të paditurës përfitues të beneficioneve që rrjedhin nga Kontrata Kolektive e Arsimit janë vetëm anëtarët e Sindikatës së Arsimit – SBASHK, ndërsa paditësi nuk ka ofruar ndonjë provë që është anëtarë i sindikatës. Po ashtu ka theksuar se të paditurës nga ana e Ministrisë së Financave nuk i është ndarë kod buxhetor për përmbushjen e obligimeve që dalin nga Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë e datës 22.01.2021, andaj e njëjta nuk ka mundësi ligjore për të përmbushur këtë obligim, pasi që bie në kundërshtim me Ligjin për Buxhetin Nr.08/L-193. Gjithashtu e paditura ka theksuar se padia e paditësit është në kundërshtim me nenin 90 par. 1.1 dhe 1.2 të Ligjit të Punës Nr.03/L-212, pasi sipas këtyre dispozitave marrëveshja kolektive lidhet mes organizatës së punëdhënësit dhe organizatës së të punësuarve, ndërsa në këtë rast Komuna e Prizrenit është punëdhënësi dhe nuk mund të obligohet në përmbushjen e kësaj kontrate, pa qenë palë nënshkruese e saj. Në fund gjykatës i ka propozuar që padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit ta refuzoj në tërësi si të pabazuar.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës si dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 8 lidhur me nenin 398 dhe 399 të LPK-së, gjeti se kërkesëpadia e paditëses është pjesërisht e bazuar, andaj pa shqyrtim të çështjes, e aprovoi pjesërisht kërkesëpadinë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Mes palëve nuk rezulton të jetë kontestues fakti se paditësja është në marrëdhënie pune tek e paditura, përkatësisht në ShFMU “Shtjefën Gjeçovi” në fshatin Zym, Komuna e Prizrenit.

Nga vërtetimi me numër 187/23 të datës 14.11.2023, të lëshuar nga drejtori i shkollës ShFMU “Shtjefën Gjeçovi” në fshatin Zym, Komuna e Prizrenit, gjykata vërtetoi faktin se paditësja H.B.J. ka gjithsej 12 vite përvojë pune.

Nga vërtetimi me numër 184/23 të datës 10.11.2023, të lëshuar nga drejtori i shkollës ShFMU “Shtjefën Gjeçovi” në fshatin Zym, Komuna e Prizrenit, gjykata vërtetoi faktin se paditësja H.B.J. është në marrëdhënie pune pranë kësaj shkolle dhe e njëjta nga data 01.01.2022 deri me datë 21.11.2022, ka punuar gjithsej 199 ditë pune.

Ndërsa, bazuar në listën e pagave të lëshuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës, vërtetohet se lartësia e pagës bazë të paditëses është 421.00 euro.

Vërtetimet e lartcekur dhe listën e pagave, gjykata e pranoi si provë materiale vendimtare, në kuptim të nenit 329 par. 1 të LPK-së, në të cilën dispozitë ligjore përcaktohet se “shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të”. Andaj pasi që vërtetimet dhe lista e pagave janë lëshuar nga

vet e paditura brenda fushëveprimit të saj, e të cilët si të tillë janë të pranueshëm edhe për vetë palën e paditur, gjykata ia fali besimin e plotë, si provë me të cilën vërtetohet fakti lidhur me vendin e punës, ditët e punës dhe vitet e përvojës së punës, konkretisht paditësja H.B.J. është në marrëdhënie pune ShFMU “Shtjefën Gjeçovi” në fshatin Zym, Komuna e Prizrenit dhe për vitin 2022, nga data 01.01.2022 deri më datë 21.11.2022, ka gjithsej 199 ditë pune dhe se aktualisht ka 12 vite përvojë pune.

Bazuar në faktet e çështjes, gjykata gjen se në rastin në fjalë zbatohen dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, me numër 01/B, numër të prot. 105, e datës 22.01.2021, të nënshkruar në mes të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës, e cila ka hyrë në fuqi më datë 22.01.2021.

Me nenin 35 par. 7 të Kontratës Kolektive të Arsimit, me numër 01/B, numër të prot. 105, e datës 22.01.2021, është përcaktuar e drejta e punëtorëve në kompensimin e shujtave dhe atë “të punësuarve (anëtarë të SBASHK-ut), u sigurohet kompensim për ushqim gjatë punës, për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimeve të ushqimit në punë, për një ditë pune, është dy euro për të punësuarit të cilët kanë marrëdhënie pune primare në institucionet arsimore...”. Ndërsa, me nenin 35 par. 8 nën par. 1.1. të Kontratës Kolektive të Arsimit, me numër 01/B, numër të prot. 105, e datës 22.01.2021 parashihet që “punëtorët (anëtarë të SBASHK-ut) në vitet jubilarë të punësimit ëprfitojnë shpërblimin jubilar në vlerë për 10 vjet të përvojës së punës në vlerë të 50% të një page bazë”.

Nga gjendja faktike e vërtetuar, rezultoi se e paditura ka detyrimin e pagesës në emër të ushqimit në punë për paditësen, ngase përmes vërtetimit të prezencës në punë është vërtetuar se paditësja Heroina Bojaxhiu Jahaj për vitin 2022, nga data 01.01.2022 deri më datë 15.11.2022, ka realizuar gjithsej 199 ditë pune. Andaj, gjykata ka vlerësuar që në rastin konkret të njëjtës i takon shuma prej 398.00 euro e cila është llogaritur duke e shumëzuar numrin e ditëve të punës 199 me 2 euro (199 x 2 euro = 398.00 euro). Po ashtu, gjykata ka gjetur se e paditura ka detyrimin e kompensimit të shpërblimit jubilar, pasi që duke u mbështetur në bazën ligjore të theksuar më lartë gjeti se paditëses i takon e drejta për kompensimin e pagës jubilarë për dhjetë vite të përvojës në punë. Më konkretisht, të njëjtës i takon kompensimi prej 50 % nga paga bazë, e të cilën e ka në lartësi prej 421.00 euro, konkretisht shuma prej 210.50 euro. Kështu, sipas vërtetimit 187/23 të datës 14.11.2023, rrjedh se paditësja në datën e lëshimit të vërtetimit ka 12 vite përvojë pune, ndërsa e njëjta 10 vite përvojë pune i ka arritur më datë 14.11.2021, në të cilën periudhë ka qenë në fuqi Kontrata Kolektive e Arsimit, me numër 01/B, numër të prot. 105, e datës 22.01.2021.

Gjykata me rastin e vendosjes jashtë seancës gjyqësore, sa i përket pjesës aprovuese është bazuar në nenin 398 të LPK-së, pasi që nuk ka ekzistuar asnjë pengesë për të aprovuar si të bazuar një pjesë të kërkesëpadisë së paditëses dhe se kjo pjesë e kërkesëpadisë bazohet në dispozitat ligjore të Kontratës Kolektive të Arsimit, me numër 01/B, numër të prot. 105, e datës 22.01.2021, ndërsa shuma e kompensimit vërtetohet nga provat që gjenden në shkresat e lëndës. Kësisoj, me nenin 398 të LPK-së përcaktohet që “kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit merititor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”.

Gjykata vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke aprovuar shumën përkatëse dhe duke llogaritur kamatën ligjore si në dispozitiv, bazuar në nenin 382 par. 1 dhe 2 të LMD-së, duke e llogaritur të njëjtën nga dita e parashtrimit të padisë në këtë gjykatë (21.11.2023),

bazuar në Mendimin Juridik për Kamatën të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. 265/2020 të datës 02.12.2020, pasi që në rastin konkret pala e paditur është vonuar në përmbushjen e obligimit ndaj palës paditëse.

Në anën tjetër, sa i përket pjesës refuzuese, gjykata vlerësoi se pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditëses është e pabazuar në ligj dhe prova. Kështu, paditësja kërkesën për kompensimin e shpërblimit jubilar e ka bazuar dhe llogaritur në pagën neto të cilën paditësja e realizon, pra duke përfshirë edhe shtesa tjera. Mirëpo, sipas nenit 35 par. 8 nën par. 1.1. të Kontratës Kolektive të Arsimit, me numër 01/B, numër të prot. 105, e datës 22.01.2021, shprehimisht përcaktohet se të punësuarve u takon shpërblimi jubilar sipas niveleve përkatëse në pagën bazë të tyre e jo në paga tjera. Në këtë drejtim, gjykata nga lista e pagave ka vërtetuar se paga bazë e paditëses është në shumë prej 421.00 euro, ndërsa paga neto e saj është në shumë prej 447.94 euro. Mbi këtë bazë, gjykata ka vlerësuar se pjesa e kërkesëpadisë së paditëses në shumë prej 13.47 euro, në emër të shpërblimit jubilar për 10 vite përvojë pune, është e pabazuar. Andaj, mbi këtë bazë gjykata aprovoi pjesërisht kërkesëpadinë e paditëses sikurse në pikën nën I. dhe II. të dispozitivit të aktgjykimit, ndërsa pjesën tjetër e refuzoi të pabazuar sikurse në pikën nën IV. të dispozitivit të aktgjykimit.

Po ashtu, gjykata vendosi jashtë seancës gjyqësore edhe në kuptim të nenit 399 par. 1 të LPK-së, pasi që pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditëses është e pabazuar në dispozita ligjore. Në këtë drejtim, sipas nenit 399 par. 1 të LPK-së parashihet që “kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadisë, atëherë ajo do të jep vendimin meritore me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadia”.

Sa i përket kundërshtimeve të të paditurës dhënë në përgjigje në padi, gjykata vlerëson se të njëjtat nuk janë të bazuara mbi dispozitat ligjore dhe nuk mbështeten në ndonjë bazë faktike apo juridike. Rrjedhimisht, gjykata erdhi në përfundim se faktet nuk ishin kontestuese dhe nuk ekzistojnë pengesa për dhënien e vendimit meritore.

Vendimin që pala e paditur t’i bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 449, 452 dhe 453 par. 2 të LPK-së, sipas Tarifës së Odës së Avokatëve, lartësia e shpenzimeve i referohet përpilimit të padisë në shumën prej 104 euro dhe taksës gjyqësore në shumën prej 20 euro, përkatësisht shumën e përgjithshme prej 124.00 euro.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në pajtim me dispozitën e nenit 398 dhe 399 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM-DIVIZIONI CIVIL
C.nr.4045/2023, datë 04.03.2024

G j y q t a r i
Uran Zogaj

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve nga dita e pranimit, pranë Gjykatës së Apelit, përmes kësaj Gjykate Themelore.